

**KONTRATE
PER THEMELIMIN E SHOQERISE
"K-AKS" SH.P.K**



NDERMJET

Z.Ylli SHEHU, i biri Qaniut dhe Nazires ,dt.lindja 12.08.1952,lindur ne Vlore , me banim ne adresen ,Lagja.13 ne Plazh-Durres.

Zj.Valbona KAPLLANI ,e bija Muhametit dhe Lutfijes,dt.lindja 21.07.1969,lindur ne Durres , me banim ne lagjen 13 Plazh-Durres .

Te lartepemendurit kane rene dakort qe te krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar ne baze te vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare " dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar" si dhe Ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private dhe privatizimit " si me poshte :

Neni .1

Te themelojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per te ushtruar veprimatri private me emertimin " K-AKS."

Kjo shoqeri e ka seline ne Tirane , ne adresen Rruga e " Durresit",Pallatet GINTASH -Laprake .

Periudha e veprimatrise se shoqerise nga momenti i marrjes se lejes per ushtrimin e aktivitetit do te jete mbi 10 vjet .

Shoqeria "K-AKS " sh.p.k ka te drejte te hapi filiale brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me miratim te organeve kopetente

Neni.2

Shoqeria "K-AKS"sh.p.k gezon statusin e personit juridik.

Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dizpozitave te kesaj kontrate,statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi,Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj .

Shoqeria ne mardhenie me te tretet pergjigjet vetem me fondet e saja dhe ortaket pergjigjen vetem per detyrimet e kesaj shoqerie.

Neni. 3

Shoqeria "K-AKS" sh.p.k do te kete si objekt te veprimtarise se saj ;

Tregtim profile alumini,aksesoret ,makineri per punimin e duraluminit ,lende e pare P.V.C,guarnicione , etj.

Neni.4

Kapitali Themeltar i shoqerise "K-AKS" sh.p.k eshte 100000(njeqindmije) leke dhe i investuar nga ortakët ne kete menyre :

1.Ylli Shehu 55%

2.Valbona kapllani 45%.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 pjese ,ku njera pjese eshte e barabarte me 1000(njemije) leke dhe kuotat e ortakeve jane sipas perqindjeve te mesiperme .

Neni.5

Kapitali Themeltar i shoqerise sipas Nenit .4 te kesaj Kontrate perfaqson kapitalet e derdhura nga sejcili ortak i nevojshem per veprimtarine e shoqerise .

Sipas kerkeses se ligjit,Kapitali Themeltar do te depozitohet ne njerën nga bankat e njohura te shtetit Shqiptar .Kapitali themeltar mund te jete i shprehur dhe ne natyre ,vleresimi i te cilit do te jete sipas legjislacionit te dale per kete qellim .

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne kete shoqeri do te shenohet edhe kapitali i derdhur nga cdo ortak .Rritja e kapitalit te cdo ortaku nuk eshte e kufizuar.

Neni.6

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me afatin e percaktuar ne kete Kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortakët.

Fitimi qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie ,pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet eshte plotesisht i transferueshem per tu depozituar ne nje nga bankat jashte Shqiperise .Fitimi neto do te ndahet nepermjet ortakeve sipas pjeseve te kontributit per krijimin e kapitalit Themeltar.

Neni.7

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE JANE

- ASAMBLEJA E ORTAKEVE
- ADMINISTRATORI
- EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR



Modalitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen ne statutin e shoqerise

Administratori i shoqerise eshte Z. Ylli SHEHU .

Neni.8

Ortaket jane te detyruar te ruajne sekretin e dokumentacionit ,informacionit ,njohurive dhe eksperiences se kembyer dhe te realizuar brenda shoqerise dhe te marrin te gjitha masat per te evituar perhapjen e tyre qofte edhe te pjeseshme. Ortaket jane pergjegjes per pasojat e demshme e te shkeljeve ndaj ligjit " Per Shoqerite Tregtare".

Neni.9

VLEFSHMERIA E KONTRATES

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe mbi 10 vjete.Sejcili ortak ka te drejte te heqin dore nga kjo kontrate duke lajmeruar ortakun tjetër 30dite perpara.Lajmerimi behet me shkrim.

Neni.10

Konfliktet qe lindin ndermjet ortakeve duhet te zgjidhen me marveshje midis tyre .Ne qoftese ortakët nuk merren vesh per zgjidhjen e konflikteve me mirkuptim,kompetent per zgjidjen e ketyre konflikteve eshte Gjykata e Faktit Tirane


Neni.11

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne Statutin e saj


Neni.12

Kjo kontrate formulohet ne 5 kopje nga te cilat nje kopje depozitohet ne Zyren e Noterise ,nje kopje ne Degen e tatimeve dhe Taksave Tirane dhe nga nje kopje e mban sejcili ortakë duke e depozituar ne dokumentat e shoqerise. Kontrata eshte e vlefshme qe nga momenti i nenshkrimit te saj nga te dy ortakët .

ORTAKET



Vallona Koplloni^o





STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "K- AKS " SHP.P.K

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni.1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "K-AKS" sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare".

Kjo shoqeri krijohet nga ortaket :

1.Ylli SHEHU , i biri Qaniut dhe Nazires,lindur ne Vlore me 12.08.1952,banues ne , Lagja.13 ,Plazh-Durres.,shtetase shqiptare .

2.Valbona KAPLLANI, e bija e Muhametit dhe Lutfijes,lindur ne Durres me 21.07.1969, bnuese ne lagjen.13 ne Plazh-Durres,shtetase shqiptare .

Oratekt e lartepemendur kane krijuar nje Shoqeri me pergjegjesi te Kufizuar te emertuar "K-AKS" .

Neni.2

Shoqeria "K-AKS" sh.p.k do te zhvilloj veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj(kontrates dhe ketij statuti).

Shoqeria "K-AKS" sh.p.k eshte person juridik.Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Neni.3

Shoqeria "K-AKS" sh.p.k krijohet per te ushtruar veprimtarin e saj per nje kohe zgjatje mbi 10 vjet .

Selia e Shoqerise eshte ne adresen Rruga e" Durresit ",Pallatet GINTASH,Laprake ne Tirane .

Kjo Shoqeri mund te zgjati afatin e veprimtaris se saj ose mund ta mbylli aktivitetin e saj para ketij afati,sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kritereve qe percaktohen ne legjilacionin ne fuqi .

Neni.4

Shoqeria "K-AKS "sh.p.k per detyrimet qe do te linden gjate aktivitetit me te trete,pergjigjet vetem me pasurine e saj .Ortaket e kesaj shoqerie ,nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie , me pasurine e tyre qe nuk eshte fituar me kapitalet e kesaj shoqerie.

Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk i pwengon ortaket te kene pavarsi ligjore ,organizative dhe te drejta pronesia jashte kesaj shoqerie.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni.5

Shoqeria "K-AKS" sh.p.k do te kete si objekt veprimtarie:
Tregtim, profile alumini,aksesoret,makineri per punimin e duraluminit, lende e pare
PVC,guarnicione ,etj.

KAPITALI THEMELTAR

Neni.6

Kapitali Themeltar i Shoqerise "K-AKS" sh.p.k eshte 100 000(njeqindmije) leke.Ky kapital Themeltar zoterohet nga dy ortake si me poshte:

1.Ylli SHEHU	55%
2.Valbona KAPLLANI	45%

Kapitali Themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme si ndermjet ortakeve ashtu dhe perkundrejt personave te trete.Transferimi i kapitalit ose i pjeseve te tij ndermjet ortakeve ose ne favor te nje personai te trete behet gjithmone me miratimin unanim te te gjitha ortakeve dhe me akt noterial.

Ne qoftese njeri nga ortaket deshiron te shese pjesen e kapitalit te tij ne natyre,duhet te respektojne te drejten e parablerjes nga ortaket e tjere.

Te gjitha veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar behen me miratimin e te gjitha ortakeve ,Vleresimi i Kapitalit Themeltar ne natyre behet nga ortaket me marveshje te vecante ose nga nje ekspert kompetent i caktuar nga ortaket.

Neni.7

Kapitali themeltar do te jete 100 000(njeqindmije) leke ku njera pjese eshte e barabarte me 1000(njemije) leke dhe kuotat e sejcilit ortak jane te percaktuara si me siper ne nenin.6.

Zmadhimi dhe zvogelimi i ketij kapitali kapitali vendoset nga Asambleja e ortakeve

Pas derdhjes se kapitalit nga ortaket e shoqerise ,i jepet sejcili nga nje vertetim ku vertetohet se sa kuota te kapitalit te shoqerise i perkasin atij dhe vlera nominale perkatese.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve e cila do te percaktoje formalitete per pranimin e pjesmarresve te rinj.Per cdo pjesmarres te ri qe do te pranohet ,shoqeria jep nga nje vertetim per numurin e kuotave qe zoteron dhe vleren nominale te tyre.

Ne raste se kuotat e kapitalit te shoqerise transferohen ne favor te nje personi te trete ai merr automatikisht te gjitha te drejatat dhe detyrimet qe ka ortaku qe i dorzon kuotat perfshi edhe ato lloj detyrimesh qe ortaku shites ka marre mbi vehte duke firmosur kontraten per themelimin e shoqerise .

Kete gje ai duhet ta pranoje duke ju dhene konfirmimin me shkrim ortakeve te tjere.Nese nuk do te behet ky konfirmim me shkrim,shitja e kuotave nje personi te trete konsiderohet pa vlere.



Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne baze te nje pavarsie te plote ekonomike .Ajo nuk pranon asnje lloj nderhyrje nga organet shtetore apo publike te cfardo lloj qofshin,perjashto kontrollleve qe organet shtetore kane te drejte te bejone ne baze te ligjeve ne fuqi.

KREU II ORGANIZIMI,DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni.8

Organi me i larte vendimor i shoqerise eshte Asmableja e Ortakeve.

Sejcili ortak ka te drejte te mari pjese ne Mbledhjen e Asamblese vete personalisht apo duke autorizuar me shkrim nje person tjeter i cili nuk eshte ortak.Cdo ortak ka aq vota sa kuota disponon ne kapital .

Ajo vendos per bilancin vjetor ,per ndryshimet ne statut ,per shtimin dhe pakesimin e Kapitalit Themeltar ,per emerimin dhe shkarkimin e administratorit , per emerimin e eksperteve kontabel dhe per shkarkimin e tyre , per hapjen e degeve,perfaqsave dhe filialeve ne rrethe te tjera,per transferimin e shoqerise ne nje forme tjeter , per zgjatjen e afatit , per marrjen ne pune dhe largimin nga detyra te drejtorit te pergjithshem, vendime per pjesmarrje ne shoqeri te tjera , aprovimin e rregullores se shoqerise, kalimin e shoqerise ne likujdim, si dhe per bilancin e likujdimit te shoqerise .

Neni .9

Vendimet e marra nga asambleja e Ortakeve ne mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme , ne perputhje me kete statut jane te detyrueshme dhe te zbatueshme per sejcilin ortak.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve behet te pakten nje here ne vit .Lajmerimi per pjesmarrje ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve behet 30 dite perpara dates se caktuar per zhvillimin e mbledhjes .ne lajmerimin per mbledhje duhet te jete shenuar,ora ,dita, vendi i zhvillimit te mbledhjes si dhe do te caktohet rendi i dites per ceshtjet qe do te shqyrtohen.

Ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve mbahet nje proces-verbal .sejcili ortak ka te drejte te marre ekstarte te tij te vertetuara rregullisht.

Asambleja e Ortakeve ,mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda 4 muajve nga mbyllja e veprimtarise ekonmike te shoqerise .

Vendimet per te cilat nevoitet unanimiteti i votave jane:

-Vendimi per shtimin apo pakesimin e kapitalit

-Shtimi i periudhes se kohezgjatjes se shoqerise .


-Futja e shoqerise ne proces likujdimi para perfundimit te afatit te percaktuar ne shkrirjen e saj.

-Ndryshimet ne statut.

Cdo lloj vendimi tjeter mund te meret me shumice te thjeshte votash.

Neni.10

Ortaket kane te drejte te marin pjese ne aktivitetin e shoqerise ne menyren e percaktuar ne Kontraten e Themelimit dhe Statut.Te mare nje pjese te fitimit te aktivitetit te shoqerise ne perpjestim me perqindjen e pjesmarrjes ne kapitalin e shoqerise te sejcilit.Te mari informacion mbi aktivitetin e shoqerise pas asnje lloj pagese.Ka te drejte te beje kontrollin e librave te shoqerise me anen e nje kontrolli



te kualifikuar, vecse me shpenzimet e veta. Te mari pjese ne Mbledhjen e Asamblese se Ortakeve , te mari nje pjese nga pasuria e shoqerise qe do te rezultoje si aktiv ne bilancin e likujdimit te shoqerise ne perpjestim me perqindjen e pjesmarrjers se tij ne kapitalin e shoqerise.

Ortaket jane te detyruar te derdhin pjesen qe ju perket ne kapitalin e shoqerise ne masen, menyren dhe brenda kohes qe eshte percaktuar ne aktin e Themelimit , ap qe mund te jete vendosur nga mbledhja e Asamblese te Ortakeve .te zbatoje te gjitha vendimet e organeve drejtuese te shoqerise , te bashkepunoje me njeri-tjetrin per te realizuar qellimet e shoqerise dhe per te cuar perpara zhvillimet e saj .

Shoqeria ka te drejte te transferoje lirisht jashte shtetit ne valuten qe deshiron ate pjese fitimi qe i takon , po keshtu dhe kundravleften e kuotave te kapitalit qe eventualisht mund te shese ,apo vleften qe i perket asaj ne ratse se shoqeria do te likujdohet .

Neni.11

Administratori i shoqerise "K-AKS" sh.p.k eshte zoti Ylli SHEHU i cili do te kryeje veprime ne emr dhe per llogari te shoqerise .

Ne mardhenie me te tretet administratori i ka te gjitha kompetencat per te kryere veprime ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj , qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise.

Administratori eshte pergjegjes individualisht ,ose solidarisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete ,ku gjate veprimeve te tij shkel ligjin,kontraten dhe statutin ose per shkelje te kryera gjate administrimit te shoqerise .

Neni 12

Mardheniet e punes me te punesuarit prane shoqerise rregullohen me kontrata individuale qe do te lidhen me sejcilin prej tyre ne baze te ligjeve ne fuqi.

Neni 13

Kontrrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i cili emerohet nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve per nje periudhe financiare tre vjecare me te drejten e perseritjes se mandatit te tij.Shkarkimi i tij behet konform dispozitave ligjore ne fuqi.

KREU III

MARDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

Neni 14

Viti financiar fillon me date 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti.perjashtim behet ne vitin e pare te krijimit te shoqerise ku fillimi eshte data e paisja me certifikat per lejeimin e ushtrimit te veprimtarise private .

Llogarite vjetore ,inventari,raportet , dhe operacionet e vitit financiar e raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe ventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve.Mirataimi i bilancit dhe dokumentacioni mbi veprimtarine vjetore behet brenda muajit mars te vitit pasardhes .



Neni.15

Pas miratimit te llogarive dhe evidentimit te fitimit Asambleja e Ortakeve percakton pjesen e fitimit qe i takon ortakeve , mbasi te jene llogaritur dhe zbritur me pare detyrimi qe i takon shtetit dhe krijimi i rezervave ligjore e statutore .per perdorimin e ketij fitimi vendos gjithashtu Asambleja e Ortakeve.

Neni.16

Llogarite ekonomike dhe ato kontable mbahen ne Shqiperi ne Leke dhe valute .
Veprimet ekonomike mbahen ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi dhe pasqyrohen ne bilancin vjetor te shoqerise .Shoqeria me qellim qe te lehtesoje punen dhe te beje sa me shpejt likujdimet cel llogari bankare ne nje prej bankave vendase ose te huaja te njohura prej shtetit Shqiptar.

KREU IV ZGJATJA E AFATIT ,PRISHJA,LIKUJDIMI

Neni.17

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne Kontraten e themelimit ,zgjatja e tij behet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ajo prishet kur mbaron afati i percaktuar dhe ortaket nuk kane rene dakort te bejne riprteritjen e e ketij afati .Shoqeria mund te shnderrohet edhe ne nje forme tjeter te percaktuar dhe te lejuar nga ligji.

Neni.18

Shoqeria tregtare hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj .per fillimin e ketij Procesi Asambleja e Ortakeve emerone nje likujdator i cili paraqet raportin e likujdimit ,gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise ,mbi menyren e e ndjekjes se operacionit te likujdimit dhe afatin e enevojshem per perfundimin e tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar ,mbi aktin dhe rregullsine e likujdimit , mbi mbylljen e procesit te likujdimit te shoqerise.

Neni.19

Zgjidhja e mosmarrveshjeve midis ortakeve eshte e percaktuar ne Kontraten e Themelimit te shoqerise.


Mosmarrveshjet qe mund te lindin ndermjet shoqerise dhe te treteve lidhur me mardheniet kontraktuale ndermjet tyre do te zgjidhen sipas klauzolave arbitrare qe shoqeria duhet te kete kujdes ti perfshije ne sejcilen kontrate qe lidh me te tretet.

Neni.20

Ky statut hartohet ne 5(pese)kopje te njejta nga te cilat nje depozitohet ne zyren e Noterise, nje kopje deposziothet ne Gjykaten e Faktit Tirane , nje kopje ne degen e tatimeve dhe nga nje kopje cdo ortake

ORTAKET

YLLI SHEHU



VALBONA KAPLLANI

